



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë 04/12/2017

Bazuar në nenin 12 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bënë:

Shpallje të Konkursit
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Ministria e Zhvillimit Rajonal
Njësia Organizative:	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Titulli i punës:	Zyrtar për Teknologji Informativ
Numri i referencës:	03/2017/DFSHP/MZHR
Niveli i pagës:	Koeficienti 6
Raporton te:	Drejtori i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për shërbime të veçanta
Kohëzgjatja e kontratës:	Tre (3) muaj
Orari i punës:	I plotë /40 orë në javë
Numri i zyrtarëve:	Një (1)
Vendi:	Prishtinë/Ndërtesa e dytë qeveritare “Ish Pallati i Rilindjes” kati i 10

1. Zyrtari për Teknologji Informativ:

Për angazhimin dhe punët e kryera zyrtari përgatitë raport mujor me shkrim për Drejtorin e Departamentit dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MZHR-së.

Detyrat kryesore janë:

- Të ndihmojë për analizimin, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të shfrytëzuesve të rrjetit kompjuterik të MZHR-së
- Të konfigurojë dhe të instalojë pajisjet e reja (p.sh. kompjuterët e ri, serverët, pajisjet e rrjetit e kështu me radhë) si dhe hardueret në rrjetin LAN dhe t'i përgatitë të njëjtat për shfrytëzim me shërbimet e rrjetit të serverëve në përputhje me standardet e Teknologjisë Informativ (TI);
- Të japë kontributin e vet për mbështetjen dhe aftësimin e shfrytëzuesve në përdorimin e aplikacioneve dhe softuerëve të ndryshëm;

- Të monitorojë zbatimin e udhëzimeve dhe të procedurave për mbështetjen e sistemit kompjuterik;
- Përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik (të harduerit dhe të softuerit) duke bërë instalimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e rrjetit kompjuterik dhe të serverëve të MZHR-së
- Të përgatitë raporte mbi detyrat e kryera dhe mbi situatën rreth mbështetjes së rrjetit kompjuterik tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe të ofrojë rekomandimet e veta, po qe se ka nevojë për një gjë të tillë;
- Të ndërlihet me Ministrinë për Administratë Publike (MAP) dhe me Departamentin për Teknologji Informativ (DTI) me qëllim të arritjes së shërbimeve më të mira për punonjësit e MZHR-së dhe përkitazi me pajisjet e TI-së;
- Përgatitja e raporteve periodike të punës;
- Kryen dhe punë tjera të kërkuara nga Udhëheqësi i njësisë;

Shkathtësitë e kërkuara: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Kualifikimi universitar i preferueshëm
- E preferueshme realizimi i trajnimeve profesionale dhe certifikimi në lëmin e TI;
- Përvoja e punës e preferueshme;
- Të jetë i aftë të përballojë dhe të organizojë punën;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve;
- Njohja e të gjitha programeve dhe lëmive të TI;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe bashkëpunim në ekip;
- Njohja e gjuhës serbe e detyrueshme;
- Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Zhvillimit Rajonal - Divizioni për Burime Njerëzore, zyra nr. 1017 kati X, ndërtesa e dytë qeveritare, "Ish Pallati i Rilindjes", Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen zyrtare të MZHR-së. Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike, nga dita e publikimit. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin arsimor, letërnjoftimin dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen! Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. MZHR-ja mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore.

Tel. 038 200 35538, prej orës 8:00 – 16:00.